



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

V E N D I M

Nr. 43, dt. 23.10.2024

MBI

MBI MIRATIMIN E APLIKIMIT TË PROJEKTIT : “ ZGJERIMI I SHËRBIMEVE PËR KUJDESIN PALIATIV NË RAJONIN E KORÇËS” TEK FONDI SOCIAL PËR VITIN 2025

Bazuar në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin nr 9335 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, i ndryshuar, nenin 38 të ligjit 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, VKM 563 datë 12.08.2005”, Për përcaktimin e përgjegjësive të Qarkut për shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesit shoqëror”, VKM 111 datë 23.02.2018 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Fondit Social”, Vendimin nr 224 date 09.04.2024 ‘Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror’, Vendim Nr. 421, Datë 26.6.2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Strukturës së Pagave, Niveleve të Pagave dhe Shtesave të Tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, Prefektit, Nënprefektit, Nëpunësve Civilë dhe Nëpunësve në disa Institucione Të Administratës Publike”, të Ndryshuar”, Vendimit nr 1 datë 22.10.2024 të Komitetit të Vlerësimit të Nevojave dhe Planifikimit të Shërbimeve Komunitare AD- HOC, pranë Këshillit të Qarkut Korçë, Ligjit Nr. 138/2014 “Për Kujdesin Paliativ në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Miratimin për aplikim tek Fondi Social, pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2025 për projektin “Zgjerimi i Shërbimeve për Kujdesin Paliativ në Rajonin e Korçës”.
2. Këshilli i Qarkut Korçë autorizon Kryetarin të nënshkruajë Marrëveshjen e Bashkëpunimit për këtë projekt.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës, zhvillimit ekonomik dhe shërbimeve.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Erjon Nexhipi



Miratuar me / 18 / Vota
Vota Pro / 18 /
Vota Kundër / 0 /
Vota Abstenim / 0 /
Zbardhur më datë /23/10/2024

Konceptoi: Këshilltar M. Aliçkollli
Konfirmoi: Këshilltar M. Bylykbashi
Pranoi: S.K.Q.K B.Muço



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

**MBI MIRATIMIN E APLIKIMIT TË PROJEKTIT : “ ZGJERIMI I SHËRBIMEVE
PËR KUJDESIN PALIATIV NË RAJONIN E KORÇËS” TEK FONDI SOCIAL PËR
VITIN 2025**

I. QËLLIMI I P/VENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij P/Vendimi është miratimi i aplikimit tek Fondi Social për vitin 2025 me projektin:
“ **ZGJERIMI I SHËRBIMEVE PËR KUJDESIN PALIATIV NË RAJONIN E KORÇËS**”
si dhe të nënshkruajë marrëveshjen e bashkëpunimit për këtë projekt.

II. VLERËSIMI I P/VENDIMIT

Ky projektvendim hartohet në përputhje me politikat e Qeverisë Shqiptare mbi shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë dhe konkretisht në kujdesin e shërbimit paliativ.

**III. ARGUMENTIMI I P/VENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË,
PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

P/Vendimi për ofrimin e shërbimit paliativ në rajonin e Korçës paraqet një mundësi të rëndësishme për të përmirësuar kujdesin shëndetësor dhe për të ndihmuar ata që përballen me sëmundje të pakurueshme. Pavarësisht sfidave, përfitimet e pritshme e bëjnë këtë vendim jetik për pacientët, familjet e tyre dhe komunitetin në tërësi. Një qasje e koordinuar dhe angazhimi i të gjitha palëve të përfshira do të jenë të nevojshme për të siguruar suksesin e këtij shërbimi.

Përparësitë e Ofrimit të Shërbimit Paliativ në Rajonin e Korçës

- **Përmirësimi i Cilësisë së Jetës:** Ofrimi i shërbimit paliativ në Korçë do të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së jetës për pacientët me sëmundje të pakurueshme, duke ulur dhimbjet dhe simptomat e tjera që ata përjetojnë.
- **Mbështetje për Familjarët:** Shërbimi do të ofrojë mbështetje dhe edukim për familjarët, duke i ndihmuar ata të përballen me sfidat emocionale dhe praktike që sjell kujdesi për të dashurit e tyre.
- **Aksesi në Kujdes të Specializuar:** Duke krijuar një qendër të dedikuar për shërbimin paliativ në këtë rajon, do të sigurohet që pacientët të kenë akses të lehtë dhe të shpejtë në kujdesin e nevojshëm, përfshirë kujdesin në shtëpi dhe terapi ditore.

- **Zhvillimi i Kapaciteteve:** Ofrimi i shërbimit do të inkurajojë trajnimin e profesionistëve të shëndetësisë dhe do të krijojë një ekip të specializuar që do të kontribuojë në zhvillimin e kujdesit shëndetësor në rajon.

2. Problematikat e Mundshme

- **Mungesa e Burimeve Financiare:** Një nga sfidat kryesore është sigurimi i financimit të qëndrueshëm për shërbimin paliativ. Kjo përfshin burimet për stafin, pajisjet dhe infrastrukturën e nevojshme.
- **Edukimi i Stafit Shëndetësor:** Mungesa e trajnimit të mjaftueshëm për profesionistët që do të ofrojnë shërbimin mund të kufizojë cilësinë e kujdesit. Krijimi i programeve të trajnimit është esencial.
- **Vështirësitë në Ndërgjegjësim:** Ka nevojë për rritjen e ndërgjegjësimin në komunitet mbi rëndësinë e shërbimit paliativ dhe se si ai mund të ndihmojë pacientët dhe familjet e tyre.

3. Efektet e Pritshme

- **Rritja e afeksionit së Pacientëve:** Duke ofruar një shërbim cilësor, pritet një rritje e kënaqësisë së pacientëve dhe familjarëve, duke kontribuar në mirëqenien e tyre emocionale dhe fizike.
- **Reduktimi i Barrës për Spitalet:** Me ofrimin e shërbimit paliativ, do të reduktohet ngarkesa në spitalet lokale, duke i lejuar ato të përqendrohen në trajtimin e sëmundjeve akute.
- **Forcimi i Bashkëpunimit Ndërinstitucional:** Krijimi i një shërbimi të tillë do të inkurajojë bashkëpunimin midis institucioneve shëndetësore dhe organizatave jofitimprurëse, duke përmirësuar rrjetin e mbështetjes për pacientët.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Bazuar në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin nr 9335 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, i ndryshuar, nenin 38 të ligjit 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, VKM 563 datë 12.08.2005”, Për përcaktimin e përgjegjësive të Qarkut për shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesit shoqëror”, VKM 111 datë 23.02.2018 “Për Krijimin dhe Funksonimin e Fondit Social”, Vendimin nr 224 date 09.04.2024 ‘Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror’, Vendim Nr. 421, Datë 26.6.2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Strukturës së Pagave, Niveleve të Pagave dhe Shtesave të Tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, Prefektit, Nënprefektit, Nëpunësve Civilë dhe Nëpunësve në disa Institucione Të Administratës Publike”, të Ndryshuar”, Vendimit nr 1 datë 22.10.2024 të Komitetit të Vlerësimit të Nevojave dhe Planifikimit të Shërbimeve Komunitare AD- HOC, pranë Këshillit të Qarkut Korçë, Ligjit Nr. 138/2014 “Për Kujdesin Paliativ në Republikën e Shqipërisë”,

V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË P/VENDIMIT

P/vendimi është i organizuar si më poshtë:

1. **Në pikën 1** parashikohet miratimi për aplikim tek Fondi Social, pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2025 për projektin “Zgjerimi i Shërbimeve për Kujdesin Paliativ në Rajonin e Korçës”.

VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E P/VENDIMIT

Institucioni që ngarkohet për zbatimin e këtij P/Vendimi është Këshilli i Qarkut Korçë, Sektori i Financës, Zhvillimit Ekonomik, Shërbimeve, Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Territorit.

VII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E P/VENDIMIT

P/Vendimi është hartuar nga një grup pune në Këshillin e Qarkut Korçë, të përbërë nga Kabineti i Kryetarit, ekspertë të projekteve për Bashkimin Evropian dhe specialistë të Kujdesit Paliativ Meri Poter .

II. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Hyrja në fuqi e këtij vendimi nuk shoqërohet me efekt financiar për buxhetin e shtetit.

KABINETI I KRYETARIT

D. Kabineti & Këshilltari për Projektet e BE;

Mariela Alickolli

Dt. _____ 2024